



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 231, Datë 30.09.2025

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 248, DATË 29.09.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “EGNATIA HYDROPOWER” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET “GOSTIMA 1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 3047 KW, “GOSTIMA 2” ME KAPACITET TË INSTALUAR 5586 KW, “GOSTIMA 3” ME KAPACITET TË INSTALUAR 5335 KW, “GOSTIMA 4” ME KAPACITET TË INSTALUAR 7396 KW, “GOSTIMA 5” ME KAPACITET TË INSTALUAR 10321 KW, “GOSTIMA 5/1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 450 KW DHE “GOSTIMA 6” ME KAPACITET TË INSTALUAR 16819 KW ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 48 864 kW” I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2524 prot., datë 26.09.2025, të Drejtorisë së Politikave të Burimeve të Rinovueshme, “Mbi disa ndryshime në vendimmarrjet e bordit të ERE-s lidhur me plotësimin e kushteve nga subjektet e licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “EGNATIA HYDROPOWER” sh.p.k.

- Me vendimin nr. 248, datë 29.09.2022, Bordi i ERE-s ka licencuar shoqërinë “EGNATIA HYDROPOWER” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gostima 1” me kapacitet të instaluar 3047 kW, “Gostima 2” me kapacitet të instaluar 5586 kW; “Gostima 3” me kapacitet të instaluar 5335 kW; “Gostima 4” me kapacitet të instaluar 7396 kW; “Gostima 5” me kapacitet të instaluar 10321 kW; “Gostima 5/1” me kapacitet të instaluar 450 kW; “Gostima 6” me kapacitet të instaluar 16819 kW; me kapacitet total të instaluar 48 864 kW, për një afat 30-vjeçar.
- Në vendimin nr. 248/2022, në pikën 2 është përcaktuar se: “Shoqëria ‘Egnatia Hydropower’ sh.p.k., të përcjellë në ERE me afat të rinovuar kontratën e qirasë me Bashkinë Përrenjas jo më vonë se data e përfundimit të saj (25.03.2031); kontratën e qirasë me Bashkinë Librazhd jo më vonë se data e përfundimit të saj (07.01.2031); kontratën e qirasë me Bashkinë Elbasan jo më vonë se data e përfundimit të saj (31.12.2030), ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku do të shtrihet projekti.”.

2. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Pas ndryshimeve të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 220, datë 01.09.2022, në Rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, është riformatuar neni 9 i rregullores “*Formati dhe dokumentacioni për aplikim*”, duke shfuqizuar gërmën “g” të pikës 2 të këtij neni, e cila përcaktonte se në dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor të paraqitur për aplikim përfshihen dhe dokumentet që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjekte që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar).
- Në këto kushte, pika 2 e vendimit nr. 248/2022, që lidhet me depozitimin e kontratave të qirasë të rinovuara ose dokumenteve ekuivalente, nuk gjen më mbështetje në kuadrin rregullator dhe duhet të shfuqizohet.
- Në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizimi është i domosdoshëm për të harmonizuar vendimin me kuadrin ligjor dhe rregullator të përditësuar, duke garantuar qartësi dhe koherencë në kushtet e licencës së shoqërisë.

3. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Ndryshimi është i nevojshëm për të shmangur pasiguritë ligjore dhe për të siguruar koherencë të vendimit me kuadrin rregullator aktual.
- Shfuqizimi i pikës 2 është i domosdoshëm pasi detyrimi i parashikuar në të nuk gjen më mbështetje në kuadrin rregullator dhe nuk përbën më një kusht të vlefshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE nr. 248, datë 29.09.2022, i ndryshuar, shfuqizohet.
2. Heqja e kushteve nuk përjashton këtë shoqëri nga detyrimi për të ruajtur në vazhdimësi të drejtën e ligjshme të përdorimit të territorit ku shtrihet veprimtaria e licencuar, në përputhje me kontratat përkatëse ose aktet e pronësisë.
3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “EGNATIA HYDROPOWER” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, FTL sh.a. dhe OSSH sh.a. lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI